



Bazuar në nenin 23, paragrafi 1, nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77/16 gusht 2010), dhe nenet 15, 16 dhe 85 paragrafi 1 të Ligjit nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/11 maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 22 dhjetor 2015, miratoi si vijon:

RREGULLORE PËR ADEKUATSHMËRINË E KAPITALIT TË BANKAVE

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj rregullore është të siguroj që bankat mbajnë kapital të mjaftueshëm për të mbuluar rreziqet nga afarizmi i tyre, të mirëmbajnë nivelin minimal të kapitalit dhe një raport të mjaftueshmerisë së kapitalit që reflekton ekspozimet ndaj rrezikut të bankës, brenda dhe jashtë bilancit të gjendjes.
2. Kjo rregullore aplikohet për te gjitha bankat e licencuara nga BQK-ja për të operuar në Republikën e Kosovës, me përjashtim të degëve të bankave të huaja.

Neni 2

Përkufizimet

1. Të gjithë termet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptim të njëjtë me termet e përkufizuara në nenin 3 të Ligjit nr.04/L-093 për banka, institucione mikrofinanciare dhe institucione financiare jobankare dhe / ose me përkufizimet në vijim për qëllimin e kësaj rregulloreje:

- a) *Bankë* - do të thotë një shoqëri aksionare e angazhuar në veprimtari bankare, duke përfshirë një subjekt të varur, të licencuar nga BQK-ja;
- b) *Degë e bankës së huaj* - do të thotë një person që është i organizuar, ka selinë e vet dhe posedon licence për tu angazhuar në veprimtari bankare në ndonjë juridiksion tjetër përveç Kosovës;

c) *Kapitali i klasës së parë i ekuitetit të zakonshëm* - nënkupton kapitalin e përhershëm të paguar dhe të lejuar të bankës i cili mund të përbëhet nga:

- i. aksionet e zakonshme të kapitalit dhe shtesat e lidhura me të
- ii. fitimet e pashpërndara

Shtesat e kapitalit të klasës së parë - nënkuptojnë:

- i. aksionet preferenciale të përhershme (ato të cilat, në rast të likuidimit të bankës, nuk paguhet asnjë shumë derisa të gjithë depozitorët dhe kreditorët tjerë janë paguar plotësisht, mirëpo paguhen tërësisht (preferencial) para se çdo aksionar i zakonshëm paguhet dhe ka të drejtë të pajtohet mbi pagesat e dividendës, por i cili nuk ka maturitet apo opion të mbajtësve të tyre për t'u kthyer);
- ii. instrumente tjera, të cilat mund të aprovohen nga BQK kohë pas kohe, si kapital i përhershëm i pranueshëm, me rregull ose urdhër.

Zbritjet e kapitalit të klasit të parë:

- i. Emri i mirë dhe mjetet e paprekshme, të cilat duhet të zbriten nga kapitali i klasit të parë para se të bëhet kalkulimi i pjesës së kapitalit të klasit të dytë;
- ii. Investimet në ekuitetin e bankave dhe institucione tjera financiare që paraqesin mbi dhjetë për qind (10 %) të kapitalit të tyre (këtu duhet të përfshihen edhe të drejtat e varura), ose investimet me një shumë më të vogël se 10% të kapitalit të tyre, por me ndikim të rëndësishëm në marrjen e vendimeve të këtyre institucioneve. Investimet në ekuitetin e bankave dhe institucioneve tjera financiare (përfshirë edhe të drejtat e varura) që përbëjnë më pak se 10% të kapitalit të tyre, por nëse në total tejkalojnë 10% të ekuitetit të bankës para zbritjeve, ku pjesa mbi 10% e ekuitetit të bankës duhet të zbritet;
- iii. Pasuria e tatimit të shtyrë;
- iv. Huazimet ndaj personave të ndërlidhur me bankën, përveç huazimeve të mbuluara me para të gatshme.

d) *Kapitali i klasës së dytë të bankës përfshin:*

- i. Rezervat e përgjithshme për humbjet nga kreditë deri në maksimum 1.25 % (për qind) të mjeteve të peshuara me rrezik për rrezikun kreditor , apo ndonjë përqindje tjetër që mund të kërkohe kohë pas kohe nga BQK-ja me rregull ose urdhër;
- ii. Aksionet preferenciale të zakonshme (duke qenë aksione të preferuara të cilat kanë maturim apo janë të kthyeshme në opsione nga mbajtësit e tyre dhe të cilat janë kumulative (kanë të drejtën e pagesës së dividendëve të kaluara të humbura) nëse banka ka optionin e shtyrjes së pagesës së dividendëve;
- iii. Aksionet preferenciale me afat (aksionet, pronarët e të cilave kanë të drejtën e kthimit / shndërrimit të tyre dhe të cilat kanë afat 5 apo më shumë vite). Këto aksione, kohë pas kohe, janë subjekt i aprovimit si kapital gjatë tërë afatit nga BQK-ja. Shuma e aksioneve preferenciale afatgjatë (aksionet me maturitet me të gjatë se 10 vite) të pranueshme për t'u përfshirë në kapitalin e klasit të dytë, do të reduktohet nga 20% (për qind) të shumës bazë në fillim të secilit nga 5 vitet e fundit të afatit të tyre;
- iv. Instrumentet e borxhit me afat, të cilat i nënshtrohen plotësisht të drejtave të depozitorëve (ato të cilat, në rast të likuidimit të bankës, nuk paguhet në asnjë shumë derisa të gjithë depozitorët të paguhet). Shuma e instrumenteve të borxhit të varur afatgjatë (me maturitet më të gjatë se 10 vite) i pranueshëm për t'u përfshirë në kapitalin e klasës së dytë do të reduktohet nga 20% (për qind) të shumës bazë në fillim të secilit nga 5 vitet e fundit të afatit të instrumentit;
- v. Instrumentet e borxhit të cilat janë detyrimisht të konvertueshme në aksione të zakonshme dhe të cilat janë të pasiguruara dhe plotësisht të pagueshme;
- vi. Borxhet e varura janë obligime, mirëpo nëse borxhet e varura janë me afat bazë të maturimit më të gjatë se 5 vite, atëherë ato mund të përfshihen si kapital i klasës së II deri në maksimum 50% të kapitali të klasës së I; dhe
- vii. Kapitali i klasës së II nuk mund të jetë më i madh se 100% i kapitali të klasës së I.

e) *Totali i kapitalit* - nënkupton shumën e kapitalit të klasës së parë dhe kapitalit të klasës së dytë.

f) *Mjetet e rrezikuara* - nënkuptojnë të gjitha mjetet monetare të mbajtura në bilancin e gjendjes së bankës, si p.sh një kredi e cila bart çfarëdo rreziku të humbjes në vlerë për atë bankë.

- g) *Zërat jashtëbilancor* - nënkuptojnë obligimet kontingjente të bankës duke përfshirë zëvendësuesit direkt të kredive, të lejuara nga banka si garancione borxhi, letër kredi standby dhe kontingjentet tjera të cilat duhet të shpalosen si fusnota në bilancin e gjendjes, por për të cilat nuk ka vlerë rreziku definitive për qëllim të përfshirjes në pjesët kryesore të bilancit të gjendjes.
- h) *Emri i mirë* - nënkupton tejkalimin e vlerës aktuale të mjeteve të bankës mbi vlerën e mjeteve në librat e bankës, e definuar më tepër sipas standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit.
- i) *Mjetet e paprekshme* - nënkuptojnë mjetet e identifikueshme jo-monetare të bankës, të cilat nuk kanë substancë fizike, të cilat mbahen dhe kontrollohen si rezultat i ngjarjeve të mëparshme dhe prej të cilave priten të rrjedhin përfitime në të ardhmen, të definuara më tepër sipas standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit.
- j) *Zëvendësues direkt i kredive* - nënkupton çfarëdo marrëveshje në të cilën banka merr rrezikun e humbjeve të lidhura kreditore nga mjetet apo kërkesat tjera të cilat nuk i ka transferuar kur rreziku i humbjes kreditore tejkalon aksionet pro rata të mjeteve ose kërkesave tjera të bankës .
- k) *Letër kreditë e lidhura me tregti* - nënkupton instrumente vetë-likuiduese afat shkurtër të cilat përdoren për të financuar qarkullimin e mallrave dhe janë të kolateralizuara me po ato mallra.
- l) *Rreziku operacional* - nënkuptohet si rrezik i humbjeve të shkaktuara nga proceset e brendshme të dështuara apo jo adekuate, të njerëzve, sistemeve dhe ngjarjeve të jashtme. Rreziku operacional përfshin rrezikun ligjor, mirëpo përjashton rrezikun strategjik si dhe atë të reputacionit.
- m) *Raporti i kredisë me vlerën (KNV)* - definohet si bilanci i shfrytëzuar i kredisë pjesëtuar me vlerën e tanishme të tregut, të objektit.

Neni 3

Minimumi i kapitalit

1. Bazuar në paragrafin 1 të Nenit 15 të Ligjit nr.04/L-093 për banka, institucione mikrofinanciare dhe institucione financiare jobankare, bankat duhet të kenë në çdo kohë, minimum shtatë (7) milionë euro, subjekt i kufizimeve nga paragrafi i 2 i Nenit 15 të Ligjit nr.04/L-093 për banka, institucione mikrofinanciare dhe institucione financiare jobankare.

2. Kërkesa nga paragrafi 1 i këtij Neni duhet të përmbushet brenda 6 muajve pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.04/L-093 për banka, institucione mikrofinanciare dhe institucione financiare jobankare.

Neni 4

Raportet e adekuatshmërisë së kapitalit

1. Bankave iu kërkohet që të mirëmbajnë raportin minimal prej 12% (për qind) të totalit të kapitalit dhe 8% (për qind) të kapitalit të klasës së parë, në raport me mjetet e peshuara me rrezik dhe rreziqeve tjera. Ky minimum aplikohet për të gjitha bankat. Sipas mandatit të saj nga paragrafi 2 i nenit 16 të Ligjit nr.04/L-093 për banka, institucione mikrofinanciare dhe institucione financiare jobankare, BQK-ja mund t'iu kërkojë bankave t'i mbajnë këto raporte në përqindje edhe më të larta se sa niveli i përcaktuar sipër.

2. BQK-ja aplikon gjithashtu raportin minimal të levës sipas nenit 9 të kësaj rregullore.

Neni 5

Mjetet e peshuara me rrezik dhe kërkesat nga zërat jashtëbilancor

1. Shkallet e peshimit të rrezikut të mjeteve të bankës me qëllim të matjes së pajtueshmërisë me këtë Rregullore janë si më poshtë:

Kategoria 1 – Shkalla e Rrezikut prej Zero Përqind (0%)

- (a) Paratë e gatshme në Euro ose valuta tjera të jashtme konvertibile.
- (b) Bilancet me BQK dhe kërkesat prej Bankave Qendrore të shteteve të klasifikuara nga agjencionet e klasifikimit, siç është e përshkruar në Aneksin I.
- (c) Mbajtja e letrave me vlerë të lëshuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe niveli lokal qeverisës (komunat).
- (d) Kërkesat direkte nga apo kërkesat të garantuara pa kushte nga qeveritë qendrore të shteteve, të klasifikuara nga agjencionet e klasifikimit, siç është e përshkruar në **Aneksin I**.
- (e) Metalet dhe gurët e çmueshëm, të vlerësuara sipas vlerave të miratuara nga BQK-ja, për secilin rast që mbahen në trezorin e bankës apo në trezorin e ndonjë depozitori, që nënkuptohet së i takon bankës.

- (f) Kreditë apo pjesët e tyre, të mbuluara me para të gatshme në Euro ose valuta tjera lehtë të konvertueshme, të mbajtura në vlerën e tanishme, të depozituara në bankë, të lëna peng dhe të bllokuara për atë qëllim.
- (g) Kërkesat ndaj fondeve të themeluara tërësisht nga një apo më shumë qeveri qendrore, bankat qendrore, bankat shumëpalëshe (multilaterale) zhvillimore, apo entitete të sektorit publik të trajtuara me rrezik sipas juridiksionit ku janë të themeluara, ndaj të cilave aplikohet peshim me rrezik 0% me kërkesat e kësaj rregulloreje. Burim i vetëm i këtyre fondeve duhet të jenë fondet e paguara nga institucionet e lartcekura në formë të pjesëmarrjes dhe jo të financuara me anë të borxheve.
- (h) Kërkesat ndaj Fondit Monetar Ndërkombëtar – (IMF-International Monetary Fund), Bankës për Shlyerje Ndërkombëtare - (BIS – Bank for International Settlements), Bankës Qendrore Evropiane (ECB – European Central Bank), dhe ndaj Komunitetit Evropian (European Community).
- (i) Kërkesat ndaj bankave shumëpalëshe të zhvillimit, si vijon: Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (International Bank for Reconstruction and Development); Korporatës Ndërkombëtare për Financa (International Finance Corporation); Bankës Ndër-Amerikane për Zhvillim (Inter-American Development Bank); Bankës Aziatike e Zhvillimit (Asian Development Bank); Bankës Afrikane për Zhvillim (African Development Bank); Bankës së Këshillit të Evropës për Zhvillim (Council of Europe Development Bank); Bankës Nordike të Investimeve (Nordic Investment Bank); Bankës së Karaibeve për Zhvillim (Caribbean Development Bank); Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (European Bank for Reconstruction and Development); Bankës Evropiane të Investimeve (European Investment Bank); Fondit Evropian të Investimeve (European Investment Fund); Agjencisë Shumëpalëshe për Garantimin e Investimeve (Multilateral Investment Guarantee Agency); Qendrës Ndërkombëtare Financiare për Mbrojtje (International Finance Facility for Immunisation); dhe Bankës Islamike e Zhvillimit (Islamic Development Bank).

Kategoria 2 – Shkalla e Rrezikut prej Njëzet Përqind (20%)

- (a) Kërkesat direkte nga apo kërkesat e garantuara pa kushte nga bankat, me klasifikim kreditor afatshkurtër nga agjencionet e klasifikimit, siç është përshkruar në **Aneksin I**.
- (b) Kreditë apo pjesët e tyre të mbuluara me kolateral në formë të letrave me vlerë, të emetuara apo të garantuara pa kushte nga bankat qendrore apo qeveritë qendrore të shteteve, të klasifikuara nga agjencionet e klasifikimit, siç është përshkruar në **Aneksin I**.

- (c) Letrat me vlerë të emetuara nga apo të garantuara pa kushte nga bankat qendrore apo qeveritë qendrore të shteteve, të klasifikuara nga agjencionet e klasifikimit, siç është përshkruar në Aneksin I.
- (d) Kreditë apo pjesët e tyre të mbuluara me kolateral, të emetuara nga, apo të garantuara nga institucionet kredituese multilaterale apo institucionet për zhvillim regional apo global, subjekt i aprovimit paraprak nga BQK-ja.
- (e) Kërkesat nga bankat, me maturitet të mbetur deri në një vit, dhe kërkesat të mbuluara me garancion të pakushtëzuar dhe të pa anulueshëm dhe letrave me vlerë të emetuara nga këto banka, të licencuara nga BQK-ja. Kërkesat nga bankat nuk duhet të përfshijnë kërkesat e shërbyera si kolateral në banka tjera, kërkesat e përfshira si komponent e fondeve vetjake të këtyre bankave dhe gjithashtu edhe kërkesat e bankave në procedurë gjyqësore.
- (f) Paratë në proces të mbledhjes (grumbullimit).

Kategoria 3 – Shkalla e Rrezikut prej Tridhjetë e Pesë Për qind (35%)

- (a) Kreditë hipotekare rezidenciale të kualifikuara – Kategoria A (KHRK-A) sipas rregullores së BQK-së për kreditë hipotekare rezidenciale..

Kategoria 4 – Shkalla e Rrezikut prej Pesëdhjetë Përqind (50%)

- (a) Kërkesat direkte me maturitet prej një viti apo me pak apo kërkesat e garantuara pa kushte nga bankat, subjekt i aprovimit paraprak nga BQK-ja, të cilat kanë klasifikim kreditor afatshkurtër nga agjencionet e klasifikimit, si është përshkruar në Aneksin I.
- (b) Kërkesat direkte nga apo kërkesat të garantuara pa kushte nga qeveritë qendrore të shteteve, të klasifikuara nga agjencionet e klasifikimit, siç është e përshkruar në **Aneksin I**.
- (c) Kreditë hipotekare rezidenciale të kualifikuara – Kategoria B (KHRK-B) sipas rregullores së BQK-së për kreditë hipotekare rezidenciale.

Kategoria 5 – Shkalla e Rrezikut Shtatëdhjetë e Pesë Përqind (75%)

- (a) Kreditë apo pjesët e tyre të mbuluara me kolateral në formë të hipotekave të banimit të prioritetit të parë, ku shuma e papaguar nuk i kalon 30 ditë vonesë (kur një kredi është në vonesë mbi 30 ditë, atëherë i gjithë ekspozimi i atij kredi-marrësi duhet të peshohet sikurse kredia, me përjashtim të kredive të mbuluara me para të gatshme dhe nëse burimi i pagesës për ekspozimin tjetër janë të ndryshme me atë të kredisë), e cila është subjekt i kushteve të mëposhtme:

- (i) Pronësia e pronës së banimit duhet të verifikohet dhe dokumentohet;
 - (ii) Maksimumi i raportit të kredisë me vlerën e patundshmërisë (KNV) nuk mund të kalojë gjashtëdhjetë e pesë për qind (65%); dhe
 - (iii) Vlera e tregut e pronave të paluajtshme duhet të mbështetet nga një vlerësues i pavarur, i cili mund të jetë në formë të vlerësimit nga vlerësuesi i kualifikuar dhe licencuar i pasurisë së patundshme, apo nga baza e tatimit të pronës së paluajtshme, e bërë nga komunat në pajtim me Ligjin mbi Tatimin e Pronës së Paluajtshme në Kosovë.
- (b) Kreditë për ndërtuesit për të financuar ndërtimin e pasurive të patundshme, ku prona e financuar ka qenë e shitur apo lëshuar me qira, në pajtueshmëri me kontratën ligjore të plotfuqishme, ku nga shitjet e vazhdueshme apo qiratë, përfituese pa kushte është banka.

Kategoria 6 – Shkalla e Rrezikut njëqind për qind (100%)

- (a) Kërkesat direkte me maturitet prej një viti apo më pak apo kërkesat e garantuara pa kushte të bankave, subjekt i aprovimit paraprak nga BQK-ja dhe të cilat nuk kanë klasifikim.
- (b) Të gjitha kërkesat tjera të debitorëve, të cilat nuk kualifikohen në kategoritë e shkallëve të rrezikut 1-4.
- (c) Lokalet afariste, fabrikat dhe pajisjet, mjetet tjera themelore dhe pasuritë tjera të patundshme si rezultat i sekuestrimit apo formave tjera të marrjes së pronave, si rezultat i dështimit të pagesave.
- (d) Kreditë hipotekare rezidenciale të kualifikuara në vonesë mbi 90 ditë pas zbritjes së provizioneve specifike.

Kategoria 7 – shkalla e rrezikut njëqind e pesëdhjetë për qind (150%)

- (a) Kërkesat direkte me maturitet prej një viti apo më pak apo kërkesat e garantuara pa kushte të bankave, subjekt i aprovimit paraprak nga BQK-ja, të cilat kanë klasifikim afatshkurtër, siç është përshkruar në Aneksin I.

2. Faktorët konvertues të zërave jashtëbilancor

Vlerat vijuese janë përcaktuar në zërat jashtëbilancor:

- a) Pjesët e pashfrytëzuara të obligimeve me afat maturimi bazë prej 1 (një) viti ose më pak dhe pjesët e pashfrytëzuara të obligimeve, të cilat janë pa kushte të anulueshme, në çdo kohë, pa marrë parasysh afatin, u caktohet 0% e vlerës së tyre nominale me qëllim të matjes së rrezikut.
- b) Letër kreditë vetë-likuiduese afatshkurta të lidhura me tregti; duke përfshirë letrat komerciale të kredisë dhe garancioneve për tender u caktohet 20% të vlerës së tyre nominale me qëllim të matjes së rrezikut.
- c) Zëvendësuesit direkt të kredive që përfshijnë garancionet e pagesave dhe letër kredi standby u caktohet 100% e vlerës së tyre nominale me qëllim të matjes së rrezikut.
- d) Çdo zë tjetër i pa përfshirë në (b) dhe (c) u caktohet 100% të vlerës nominale për konvertim në ekuivalent të bilancit të gjendjes.

Neni 6

Rreziku operacional

1. Bankat duhet të aplikojnë qasjen e treguesit bazik (QTB) sipas kornizës së kapitalit nga Basel II.

- a) Sipas QTB-së, një ngarkesë e kapitalit prej pesëmbëdhjetë përqind (15%) të të hyrave bruto duhet t'iu shtohet mjeteve të rrezikuara të bankës për kalkulim të raportit të rrezikut të mjeteve. Të hyrat bruto definohe si të hyrat neto nga interesi plus të hyrat neto jo nga interesi. Është e menduar që kjo masë duhet:
 - i. të jetë bruto nga çfarëdo ngarkese (p.sh për interesin e papaguar);
 - ii. të jetë bruto nga shpenzimet operative, përfshirë ngarkesat e paguara ofruesve të shërbimeve të jashtëm;
 - iii. të mos përfshijë fitimet/humbjet nga shitja e letrave me vlerë të cilat mbahen ne librat e bankës për qëllime jo tregtimi;
 - iv. të mos përfshijë pozicione jo të rregullta apo të jashtëzakonshme si dhe të hyra që rrjedhin nga sigurimi.
- b) Për bankat e sapo themeluara, me të dhëna më pak se tri vjet, duhet të përdor të hyrat bruto deri në datën e caktuar me qëllim të arritjes deri te mesatarja e të hyrave bruto, derisa të hyrat bruto për kuartalet e mbetura të lihen zero.

2. Me aprovimin paraprak të BQK-së, bankat mund të aplikojnë qasjen e standardizuar për kalkulim të kapitalit për rrezik operacional. Sipas qasjes së standardizuar kërkesa për kapital për rrezikun operacional është mesatarja e tri viteve e treguesve relevant të mjeteve të rrezikuara, të llogaritura çdo vit sipas linjave biznesore (në pajtim me Aneksin II dhe Aneksin III). Për secilin vit, kërkesa negative për kapital në një linjë biznesore, që rrjedh nga një tregues relevant negativ mund të ngarkohet në total. Sidoqoftë, kur ngarkesa totale për kapital për të gjitha linjat biznesore brenda një viti të caktuar është negative, atëherë e dhëna mesatar për atë vit duhet të jetë zero. Mesatarja tre vjeçare llogaritet në bazë të vrojttimeve të tre viteve të fundit, në fund të secilit vit financiar. Kur të dhënat e audituara nuk janë në dispozicion, vlerësimet nga banka mund të përdoren.

Neni 7

Rreziku i tregut

Nëse BQK vlerëson se banka ka ekspozim të lartë ndaj rrezikut të tregut, mund të kërkojë kapital shtesë ndaj bankës.

Neni 8

Planifikimi i kapitalit

BQK-ja kërkon nga bankat që të zhvillojnë një proces të brendshëm të planifikimit të adekuatshmërisë së kapitalit, në raport me profilet e tyre të rrezikut, i cili në vazhdimësi paraqet nivelin e adekuatshmërisë së kapitalit të vlerësuar nga ana e bankës. Procesi i brendshëm i planifikimit të adekuatshmërisë së kapitalit nga bankat, do të jetë subjekt i vlerësimit nga ana e BQK-së.

Neni 9

Raporti i levës

1. Neni 16.2 i Ligjit nr.04/L-093 për banka, institucione mikrofinanciare dhe institucione financiare jobankare, jep fuqi BQK-së të caktojë raportin minimal të levës.

2. Bankat duhet të mirëmbajnë raportin minimal të levës prej shtatë për qind (7%). (Raporti i levarazhit është i barabartë me totalin e ekuitetit / totalin e mjeteve).

Neni 10
Zbatimi, masat përmirësuese dhe dënimet civile

Çdo shkelje e dispozitave të kësaj rregulloreje do të jetë subjekt i masave përmirësuese dhe ndëshkuese, siç përcaktohet në Ligjin nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore dhe Ligjin nr.04/L-093 për banka, institucione mikrofinanciare dhe institucione financiare jobankare.

Neni 11
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave, e miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore më 26 prill 2013 dhe Rregullorja për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave, e miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore, më 26 shkurt 2015, si dhe çdo dispozitë tjetër që është në kundërshtim me këtë rregullore.

Neni 12
Shtojcat

Pjesë përbërëse të kësaj rregulloreje janë Aneks I, Aneks II dhe Aneks III.

Neni 13
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi më 1 janar 2016.

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Prof. Dr. Bedri Peci

Aneks I

| <u>Kërkesat nga Bankat Qendrore dhe Qeveritë</u> | | | | | | |
|------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------|-------------------|-----------------------|--------------------|---------------|----------------------|
| Klasifikimi | AAA deri AA- | A+ deri A- | BBB+ deri BBB- | BB+ deri B- | Nën B- | Pa klasifikim |
| Peshimi me rrezik | 0% | 20% | 50% | 100% | 150% | 100% |
| <u>Kërkesat nga bankat</u> | | | | | | |
| Klasifikimi | AAA deri AA- | A+ deri A- | BBB+ deri BBB- | BB+ deri B- | Nën B- | Pa klasifikim |
| Peshimi me rrezik për kërkesat me afat të maturitetit më të gjatë se tre (3) muaj | 20% | 50% | 100% | 100% | 150% | 100% |
| Peshimi me rrezik për kërkesat me afat të maturitetit deri në tre (3) muaj | 20% | 20% | 20% | 50% | 150% | 100% |

| Interpretimi | Moody's | | S&P | | Fitch | |
|------------------------------------------------|---------------------|------------------------|---------------------|------------------------|---------------------|------------------------|
| | Afat-gjatë | Afat - shkurtër | Afat-gjatë | Afat - shkurtër | Afatgjatë | Afat - shkurtër |
| Klasifikimi i shkallëve të investimeve | Klasi-fikimi | Klasi-fikimi | Klasi-fikimi | Klasi-fikimi | Klasi-fikimi | Klasi-fikimi |
| Kualiteti më i lartë kreditor | Aaa | P-1 | AAA | A1+ | AAA | F1+ |
| Kualitet i lartë kreditor | Aa1 | | AA+ | | AA+ | |
| | Aa2 | | AA | | AA | |
| | Aa3 | | AA- | | AA- | |
| Kapacitet i fuqishëm i pagesës | A1 | P-2 | A+ | A1 | A+ | F1 |
| | A2 | | A | | A | |
| | A3 | | A- | | A- | |
| Kapacitet adekuat i pagesës | Baa1 | P-3 | BBB+ | A-3 | BBB+ | F2 |
| | Baa2 | | BBB | | BBB | |
| Klasifikimi i fundit i shkallës së investimeve | Baa3 | | BBB- | | BBB- | |
| | | | | | | |

| Klasifikimi i shkallëve spekulative | | | | | | |
|-----------------------------------------------|-------|--------------|-------------|---|----------|---|
| Spekulative | Ba1 | Not prime | BB+ | B | BB+ | B |
| Zhvillim i rrezikut kreditor | Ba2 | | BB | | BB | |
| Për shkak të ndryshimeve ekonomike | Ba3 | | BB- | | BB- | |
| Spekulim i lartë | B1 | | B+ | | B+ | |
| Rreziku kreditor prezent, | B2 | | B | | B | |
| Me margjinë të kufizuar sigurie | B3 | | B- | | B- | |
| Rrezik i lartë mos pagese, | Caa1 | | CCC+ | C | CC+ | C |
| Kapaciteti i varur nga kushtet, | Caa2 | | CCC | | CCC | |
| e pandërprera favorizuese | Caa3 | | CCC-, CC | | CCC-, CC | |
| Mos pagesë, | Ca, C | | C, D | D | C, D | D |
| Megjithatë, perspektivë e kthimit të pjesshëm | | | | | | |

Aneks II

Formula për kalkulimin e ngarkesës së kapitalit për rrezik operacional, sipas Qasjes së Treguesve Bazik (QTB) është:

$$KBIA = \{\sum(GI1 \dots n \times \alpha)\}/n$$

Ku:

KBIA = Ngarkesa për kapital sipas QTB-së

GI = të hyrat bruto vjetore të bankës, kur janë pozitive, gjatë tri viteve të mëparshme

n = numri i tri viteve të mëparshme kur të hyrat bruto vjetore janë pozitive

$$\alpha = 15\%$$

Formula për kalkulimin e ngarkesës së kapitalit për rrezik operacional, sipas Qasjes së Standardizuar (QS) është:

$$KSA = \{\sum \text{vitet } 1-3 \max[\sum(GI1-8 \times \beta1-8), 0]\}/3$$

Ku:

KSA = ngarkesa e kapitalit sipas QS

GI1-8 = të hyrat bruto vjetore, për vitin e caktuar, për secilën nga tetë linjat biznesore

B1-8 = faktori fiks beta (i definuar në aneksin III).

Aneks III

| Linjat biznesore | Lista e aktiviteve | Përqindja |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|
| Financa korporative | <p>Sigurimi i instrumenteve financiare dhe/ose plasimi i instrumenteve financiare në një bazë detyrimore të kompanisë</p> <p>Shërbimet e lidhura me përkrahjen</p> <p>Këshilla Investuese</p> <p>Këshillat ndërmarrjeve mbi strukturën e kapitalit, strategjisë industriale dhe çështjeve të lidhura dhe këshillave dhe shërbimeve të lidhura me bashkimin dhe blerjet e ndërmarrjeve</p> <p>Kërkime investuese, analiza financiare dhe forma tjera të rekomandimeve të përgjithshme lidhur me tansaksionet në instrumente financiare</p> | 18% |
| Tregti dhe shitje | <p>Tregtimi në llogari personale</p> <p>Ndërmjetësim parash</p> <p>Pranim dhe ridërgim të urdhëresave në lidhje me një apo më tepër instrumente financiare</p> <p>Zbatimi i urdhëresave në emër të klientëve</p> <p>Plasimi i instrumenteve financiare pa bazë detyrimi nga kompania</p> <p>Operimi i pajisjeve tregtare multilaterale</p> | 18% |
| Ndërmjetësim me pakicë (Aktivitetet me persona fizik individual apo me entitete të vogla dhe të mesme) | <p>Pranim dhe ridërgim të urdhëresave në lidhje me një apo më tepër instrumente financiare</p> <p>Zbatimi i urdhëresave në emër të klientëve</p> <p>Plasimi i instrumenteve financiare pa bazë detyrimi nga kompania</p> | 12% |
| Veprime bankare komerciale | <p>Pranimi i depozitave dhe fondeve tjera të ri pagueshme</p> <p>Kredi-dhënie</p> <p>Qira-dhënie (Leasing) financiare</p> <p>Garancione dhe detyrime financiare</p> | 15% |

| | | |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----|
| Veprime bankare me pakicë / (eng. Retail) | Pranimi i depozitave dhe fondeve tjera të ri pagueshme | |
| Ndërmjetësim me pakicë (Aktivitetet me persona fizik individual apo me entitete të vogla dhe të mesme) | Kredi-dhënie Qira-dhënie (Leasing) financiare Garancione dhe detyrime financiare | 12% |
| Pagesa dhe barazime | Shërbime ridërgimi të parave Emetim dhe administrimi i llojeve të pagesës | 18% |
| Shërbimet e ndërmjetësimit (eng. Agency services) | Ruajtja dhe administrimi i instrumenteve financiare në llogari të klientëve, duke përfshirë kujdestarinë dhe shërbimet e ngjashme si menaxhimi i parasë së gatshme/kolateralit. | 15% |
| Menaxhim i mjeteve | Menaxhim portofoli Veprimet për investimet e përbashkëta në letrat me vlere të transferueshme (ang. Undertakings for Collective Investment in Transferable Securities) Forma tjera të menaxhimit të mjeteve | 12% |